



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-05

Prokurori kundër Salih Mustafës

Vendosi: Trupi Gjykses I

Gjykatëse Mapi Feld-Folia, kryegjykatëse

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatës Zhilber Biti, gjykatës raportues

Gjykatës Vladimir Mikula, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 25 prill 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër drejtuar Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës për Parashtrime të Mëtejshme

T'i njoftohet:

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të të akuzuarit

Julius von Bone

Administratores

Fidelma Donlon

Mbrojtëses së viktimave

Ani Pues

TRUPI GJYKUES I (Trupi Gjykues) nxjerr këtë vendim ku kërkon nga Ministria e Drejtësisë së Kosovës (Ministria e Drejtësisë) të bëjë parashtrime të mëtejshme.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 4 shkurt 2022, Trupi Gjykues lëshoi “Vendim mbi Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe ku Kërkohen Parashtrime” (Vendimi), në të cilin Trupi Gjykues, ndër të tjera, urdhëroi Ministrinë e Drejtësisë që, deri më 16 mars 2022, t’i paraqiste Trupit Gjykues përgjigjet e saj lidhur me një numër pyetjesh konkrete të parashtruara në Vendim.¹

2. Më 16 mars 2022, Ministria e Drejtësisë paraqiti parashtrimet e saj (Parashtrimet e MD-së).²

3. Më 25 mars 2022, mbrojtësja e viktimave dorëzoi “Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave ndaj Përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës lidhur me Kompensim dhe Kërkesë për Qartësim të Mëtejshëm” (Parashtrimet e Viktimave).³

II. PYETJET E TRUPIT GJYKUES DREJTUAR MINISTRISË SË DREJTËSISË

4. Trupi Gjykues kujton se, në Vendim, ai kërkoj nga Ministria e Drejtësisë të paraqiste parashtrime lidhur me pyetjet në vijim.

- Në rast se, z. Salih Mustafa (i akuzuari) do të shpallej fajtor dhe Trupi Gjykues do të lëshonte Urdhrin për Zhdëmtim, në qoftë se i akuzuari nuk

¹ KSC-BC-2020-05, F00310/RED, Trupi Gjykues I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Zbatimin e Nenit 22(9) të Ligjit, ku Përcaktohen Hapat e Mëtejshëm Proceduralë në Këtë Çështje dhe ku Kërkohen Parashtrime*, 4 shkurt 2022, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00344, Ministria e Drejtësisë së Kosovës, *Përgjigje në lidhje me shkresën KSC-BC-2020-05*, 14 mars 2022, publike.

³ KSC-BC-2020-05, F00365, Mbrojtësja për Viktima, *Parashtrim i Mbrojtëses së Viktimave ndaj Përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës lidhur me Kompensim dhe Kërkesë për Qartësim të Mëtejshëm*, 25 mars 2022, publik.

do të jetë në gjendje të paguajë zhdëmtimet që do të urdhërojë Trupi Gjykses, a do të mund të përfitonin viktimat e krimeve nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara (DHS) dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur në nenin 19(1), pjesa 1.26, dhe 62(1), pjesa 1.5, e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, apo nga cilido program përkatës për kompensim, përfshirë atë të krijuar sipas Ligjit Nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave (Pyetja 1);

- A do të përfitonin viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur më lart apo nga cilido program përkatës për kompensim duke ruajtur anonimitetin pas nxjerrjes së Urdhrit për Zhdëmtim nga Trupi Gjykses. (Pyetja 2);
- Për të ruajtur anonimitetin e viktimave, a do të mund Administratorja, me ndihmën e Ministrisë së Drejtësisë të Kosovës, sipas nevojës, të bënte kërkesë për dëmshpërblim nga Fondi për Kompensimin e Viktimave të përmendur më lart apo nga cilido program përkatës për kompensim të përmendur më lart në emër të viktimave, pas nxjerrjes së Urdhrit për Zhdëmtim nga Trupi Gjykses; dhe (Pyetja 3);
- Në rast se viktimat e krimeve nën juridiksionin e DHS-së nuk do të mund të përfitonin dëmshpërblim nga cilido program ekzistues për kompensim, a do të mund të krijohej një fond për këtë qëllim, i financuar nga buxheti i Kosovës ose nga burime të tjera, ku Administratorja do të mund të bënte kërkesë për dëmshpërblim në emër të viktimave, me qëllim që të ruhet anonimiteti i tyre. Në këtë kontekst, Trupi Gjykses konkretisht thekson se financimi i mbrojtjes së të akuzuarve para DHS-së nga buxheti i Kosovës është bërë i mundshëm me anë të Ligjit Nr. 05054 për Mbrojtjen Juridike

dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë DHS-së (Pyetja 4).⁴

III. PARASHTRIME

5. Trupi Gjygues vë në dukje se Ministria e Drejtësisë nuk jep përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj pyetjeve të parashtruara prej Trupit Gjygues, por paraqet një përmbledhje të legjislacionit ekzistues; pas asaj përmbledhjeje Ministria e Drejtësisë informon Trupin Gjygues se: “I) Fondi për kompensim të viktimave i përcaktuar me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, është i vetmi fond për kompensimin e viktimave të krimit; II) Komisioni Qeveritar për Kompensim të Viktimave të Krimit është mekanizmi përkatës për të shqyrtuar dhe vendosur për kërkesat për kompensim të viktimave të krimit; III) Kërkesa për kompensim dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë nga vetë viktima, përfaqësuesi i autorizuar i tij/saj apo mund të referohet nga Gjykata; IV) Kërkesa e kompletuar duhet të dorëzohet brenda afateve të përcaktuara me ligj; V) Për të përfituar nga fondi i kompensimit, viktima duhet t’i plotësojë kriteret ligjore të cekura më lartë; dhe VI) Në lidhje me kërkesën Komisioni vendos brenda afateve përcaktuara me ligj”.⁵ Në fund, Ministria e Drejtësisë thotë se është në dispozicion për të ofruar çfarëdo sqarimesh të mëtejshme.⁶

6. Mbrojtësja e viktimave parashtron se Ministria e Drejtësisë nuk ka dhënë përgjigje të drejtpërdrejtë ndaj asnjë pyetjeje të parashtruar prej Trupit Gjygues; thjesht ka paraqitur një përmbledhje të ligjit ekzistues, ku disa përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara prej Trupit Gjygues mund të deduktohen nga kjo përmbledhje.⁷ Mbrojtësja e viktimave ngre disa shqetësime lidhur me

⁴ Vendimi, para. 47.

⁵ Parashtrimet e MD-së, f. 5.

⁶ Parashtrimet e MD-së, f. 5.

⁷ Parashtrimet e Viktimave, para. 14-15.

përmbledhjen e ligjit ekzistues që ka paraqitur Ministria e Drejtësisë. Në këtë aspekt, mbetet e paqartë nëse viktimat në këtë çështje do të kenë të drejtë për kompensim, sepse kjo duket se varet nga kompetenca diskrecionale e Komisionit Qeveritar për Kompensim të Viktimave që do të shqyrtojë kërkesat e tyre, që për rrjedhojë i përball viktimat me një rrezik serioz se kërkesa do t'u refuzohet.⁸ Duket se nuk ka asnjë ndihmë juridike në dispozicion për dorëzimin e kërkesave për kompensim.⁹ Mbrojtësja e viktimave gjithashtu ngre problemin e afatit të parashkrimit, zbatimin e të cilit nuk qartësohet në Parashtrimet e MD-së.¹⁰ Sa i përket Pyetjes 2, mbrojtësja e viktimave thekson se Parashtrimet e MD-së nuk trajtojnë se në çfarë mënyre viktimat mund të ruajnë anonimitetin.¹¹ Gjithashtu, mbrojtësja e viktimave thekson faktin se në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, viktimat do të duhet së pari të përpiqen të zbatohet çfarëdo urdhri për zhdëmtim kundër të akuzuarit, gjë që do të ndikonte në anonimitetin e tyre.¹² Së fundi, mbrojtësja e viktimave është e mendimit se Ministria e Drejtësisë nuk jep përgjigje të qartë ndaj Pyetjeve 3 dhe 4, të parashtruara prej Trupit Gjykses.¹³ Rrjedhimisht, mbrojtësja e viktimave kërkon prej Trupit Gjykses t'i kujtojë Ministrisë së Drejtësisë obligimin e saj për bashkëpunim sipas kornizës ligjore të DHS-së, dhe t'i riparaqesë kërkesën e vet Ministrisë së Drejtësisë me qëllim që të paraqiten përgjigjet e plota ndaj pyetjeve të parashtruara prej Trupit Gjykses në Vendim.¹⁴

⁸ Parashtrimet e Viktimave, para. 20; kjo vlen veçanërisht për krimet që nuk përfshihen në nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-036 për Kompensim të Viktimave të Krimit (Ligji për Kompensim të Viktimave të Krimit), siç janë trajtim çnjerëzor dhe tortura.

⁹ Parashtrimet e Viktimave, para. 25.

¹⁰ Parashtrimet e Viktimave, para. 26.

¹¹ Parashtrimet e Viktimave, para. 21.

¹² Parashtrimet e Viktimave, para. 22.

¹³ Parashtrimet e Viktimave, para. 23.

¹⁴ Parashtrimet e Viktimave, para. 32.

IV. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

7. Trupi Gjykses mban parasys h nenet 22(3), (7), 40(2), 44(6) dhe 53(1) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Ligji) dhe rregullat 49(1), 116(1), 167-168 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (Rregullorja).

V. ANALIZË

8. Pasi ka shqyrtuar me kujdes Parashtrimet e MD-së, Trupi Gjykses konstaton se Ministria e Drejtësisë ka paraqitur vetëm një përmbledhje të ligjit ekzistues. Megjithëse, Trupi Gjykses konsideron se korniza ligjore e zbatueshme është informacion i dobishëm, Trupi Gjykses përgjithësisht pajtohet me vlerësimin e mbrojtëses së viktimave, dhe konstaton se Ministria e Drejtësisë nuk paraqiti përgjigje të drejtpërdrejta ndaj asnjërës prej pyetjeve të Trupit Gjykses, të parashtruara në Vendim.

9. Sa i përket Pyetjes 1, megjithëse Ministria e Drejtësisë qartëson se Fondi për Kompensimin e Viktimave që përmendet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës është i vetmi fond në dispozicion për kompensimin e viktimave të krimeve të caktuara, Parashtrimet e MD-së nuk japin përgjigje të qarta se si i merr vendimet e veta Komisioni Qeveritar për Kompensim të Viktimave të Krimit , veçanërisht në lidhje me krimet që nuk përfshihen në nenin 6 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Gjithashtu, problemet që lidhen me afatin e parashkrimit,¹⁵ veçanërisht në çështjen aktuale ku pretendohet se krimet janë kryer para 23 vjetësh, thjesht nuk trajtohen në Parashtrimet e MD-së. Për më tepër, në rast se i akuzuari shpallet fajtor, por nuk do të jetë në gjendje të paguajë zhdëmtimet e urdhëruara nga Trupi Gjykses, Ministria e Drejtësisë u pyet se a do të ishte e

¹⁵ Parashtrimet e Viktimave, para. 26.

mundshme që urdhri për zhdëmtim lidhur me viktimat në këtë çështje të materializohet përmes një fondi, në vend që viktimat t'i paraqesin përsëri kërkesat e tyre për dëmshpërblim një fondi të tillë. Në këtë kuptim, sipas mendimit të Trupit Gjykses përgjigjet e paraqitura nga Ministria e Drejtësisë janë thjesht të parëndësishme, sepse lidhur me kërkesat e viktimave vendos Trupi Gjykses dhe funksioni i vetëm i fondit në dispozicion do të ishte zbatimi i urdhrin për zhdëmtim të lëshuar prej Trupit Gjykses.

10. Sa i përket Pyetjes 2, Trupi Gjykses kujton se viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje përfitojnë prej masave mbrojtëse në raport me publikun,¹⁶ dhe për këtë arsye është me rëndësi thelbësore për Trupin Gjykses të dijë nëse viktimat mund të përfitojnë nga Fondi për Kompensimin e Viktimave dhe në të njëjtën kohë të ruajnë anonimitetin. Megjithatë, Ministria e Drejtësisë nuk jep përgjigje të qartë në lidhje me këtë pikë kyçe. Ndonëse, Ministria e Drejtësisë qartëson se kërkesa mund të dorëzohet nga përfaqësuesi i autorizuar i viktimave ose të referohet nga Gjykata,¹⁷ mbetet e paqartë nëse këto viktima mund të mbesin anonime. Gjithashtu, Trupi Gjykses thekson se, në mënyrë që të ruhet anonimiteti i viktimave, nuk parashikon që ata së pari të kërkojnë kompensim prej të akuzuarit në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, në kundërshtim me atë që sugjerohet në Parashtrimet e MD-së ku përmendet neni 10 i Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin.

11. Sa u përket Pyetjeve 3 dhe 4, Trupi Gjykses konstaton se Ministria e Drejtësisë nuk ka dhënë përgjigje të njëmendta lidhur me hapat proceduralë të paraqitur prej Trupit Gjykses dhe mundësinë e realizimit sa i përket zbatimit. Lidhur me Pyetjen 3, Ministria e Drejtësisë duhet të tregojë nëse Administratorja,

¹⁶ KSC-BC-2020-05, F00075, Trupi Gjykses I, *Vendimi i Parë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 10 shkurt 2021, publik, para. 21(b); F00105/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Dytë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 30 prill 2021, publik, para. 54(e)-(f); F00126/RED, Trupi Gjykses I, *Version i Redaktuar Publik i Vendimit të Tretë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave*, 21 maj 2021, publik, para. 42(d)-(e).

¹⁷ Parashtrimet e MD-së, f. 5, numër III.

me udhëzim të Trupit Gjykses, mund të konsiderohet si “përfaqësues i autorizuar” i viktimave në këtë çështje, ndërkohë që viktimat të mbeten anonime. Gjithashtu, pyetja e parashtruar prej Trupit Gjykses kishte të bënte me zbatimin e urdhrit të vet për zhdëmtim, e jo me paraqitjen e kërkesave për kompensim. Në lidhje me Pyetjen 4, Trupi Gjykses dëshiron të dijë se a parasheh Ministria e Drejtësisë krijimin e një fondi për të mbuluar pagesat e urdhrit për zhdëmtim që do të lëshohet prej Trupit Gjykses, në rast se i akuzuari shpallet fajtor, por nuk do të jetë në gjendje të paguajë zhdëmtimet e urdhëruara ose në qoftë se parasheh zgjerimin e fushëveprimit të zbatimit të ndonjë fondi tjetër ekzistues, siç është ai i krijuar sipas Ligjit Nr. 05-054 për Mbrojtjen Juridike dhe Mbështetjen Financiare të Personave të Akuzuar Potencial në Proceset Gjyqësore Pranë DHS-së. Ministria e Drejtësisë nuk jep asnjë përgjigje në këtë kontekst. Megjithatë, kjo është veçanërisht me rëndësi duke marrë parasysh kufizimet e legjislacionit aktual, siç shpjegon Ministria e Drejtësisë. Trupi Gjykses konsideron se një parashtrim material prej Ministrisë së Drejtësisë lidhur me dy pyetjet e fundit, është po aq thelbësor për çdo vendim të ardhshëm prej Trupit Gjykses.

12. Trupi Gjykses vë në dukje parashtrimin e Ministrisë së Drejtësisë se “do të jetë në dispozicion për të ofruar çfarëdo sqarimi tjetër shtesë [...]”,¹⁸ dhe kujton obligimin e të gjitha subjekteve dhe personave në Kosovë, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, për bashkëpunim me DHS-në në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses e konsideron të nevojshme të riparashtrrojë në tërësi Pyetjet 1 deri në Pyetjen 4 të parashtruara në Vendim, dhe urdhëron Ministrinë e Drejtësisë që, deri të premtën, më 10 qershor 2022, të paraqesë parashtrime materiale, duke marrë parasysh paragrafët 9 deri 11 më lart, përfshirë përmendjen e legjislacionit përkatës, kur është e nevojshme.

¹⁸ Parashtrimet e MD-së, f. 5.

13. Në pajtim me rregullën 49(1) të Rregullores, dërgimi i urdhrin aktual te Ministria e Drejtësisë së Kosovës bëhet përmes Administratores.

VI. VENDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **MIRATON** kërkesën e mbrojtëses së viktimave për qartësim të mëtejshëm;
- b. **URDHËRON** Ministrinë e Drejtësisë së Kosovës që, në pajtim me nenin 53(1) të Ligjit, të dorëzojë parashtrime materiale lidhur me Pyetjen 1 deri në Pyetjen 4, sikurse përcaktohet në Vendim, duke marrë parasysh paragrafët 9 dhe 11 më lart, deri **të premtën, 10 qershor 2022**; dhe
- c. **URDHËRON** Administratoren t'i dërgojë urdhrin aktual Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Kryegjykatëse

/nënshkrimi

Gjykatës Zhilber Biti

/nënshkrimi/

Gjykatës Roland Dekers

E hënë, 25 prill 2022

Në Hagë, Holandë.